


E DREJTA PËR INFORMIM



Mbledhje e Komitetit Ekzekutiv të ICIC

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mori pjesë në mbledhjen e dytë për këtë vit të Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (International Conference of Information Commissioners-ICIC).

Një nga pikat e rëndësishme të agjendës së takimit ishte shtimi dhe konsolidimi i ndërveprimit me UNESCO (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën), në kuadër të zbatimit të Memorandumit të Bashkëpunimit.

Anëtarët e Komitetit diskutuan edhe mbi propozimet për përmirësimin e Kartës së Johannesburgut, akti kryesor rregullator i funksionimit të organizatës, si dhe për masat organizative në funksion të zhvillimit të edicionit të 14-të të ICIC.

Komiteti Ekzekutiv përbëhet nga Komisionerët e Meksikës, Shqipërisë, SHBA, Kilit, Filipineve, Kenias, Afrikës së Jugut dhe Bermudës.

Për më tepër, Zyra e Komisionerit mori pjesë në mënyrë aktive në tre takime të Komitetit ndërkombëtar të Planifikimit të Konferencës së 14-të të ICIC, të cilat u zhvilluan online gjatë muajit mars.

Anëtarët e këtij Komiteti diskutuan mbi tematikat që do trajtohen gjatë Konferencës dhe programin, i cili është në fazat e fundit të konsultimit.

PËRMBLEDHJE MUJORE E VENDIMEVE

Vendim Nr. 5 - Bashkia Memaliaj

Vendim Nr. 6 - Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

Vendim Nr. 7 - Bashkia Kavajë

Vendim Nr. 9 - Bashkia Mallakastër

Vendim Nr. 10 - Bashkia Kamëz

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit mars 2023

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit mars 2023, ka dhënë 5 vendime urdhërimi në zbatim të ligjit 119/2014 për të drejtën e informimit.

Me anë të vendimit nr. 10 datë 21.03.2023, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj "Bashkisë Kamëz", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Kërkuesi ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, si më poshtë:

1.Videoregjistrimin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Kamëz të zhvilluar nëpërmjet aplikacionit zoom datë 16.12.2022. (Bazuar në nenin 69, Rregjistrimi i Mbledhjes së Këshillit Bashkiak, pika 2); 2.Kopje të njoftimit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të 6 muajve të fundit; 3.Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, të 6 muajve të fundit, sikurse e parashikon rregullorja e KB (bazuar në nenin 51 dhe nenin 85 të Rregullores së Këshillit Bashkiak). Procesverbalit përfshin: -Datën e mbajtjes së mbledhjes; -Orën e fillimit të mbledhjes; -Vendin e mbajtjes së mbledhjes; -Llojin e mbledhjes (e rregullt, jashtë rradhe, emergjente, etj); -E hapur ose e mbyllur; -Emrin e këshilltarëve të pranishëm; - Orari i hyrjes dhe daljes së këshilltarëve në mbledhjen e këshillit; -Emri mbiemri i këshilltarëve sipas nenit 30; -Deklaratat e personave që kanë konflikt interesi me projektvendimin e propozuar, rasti i personave të punësuar në atë sektor për të cilën projektvendimi ka të bëjë; -Gjithçka ç'ka u tha në mbledhje nga folësit; -Vendimet e marra; -Forma dhe rezultati i votimit, emrat e këshilltarëve që kanë votuar; -Firmat e komisionit të verifikimit të procesverbalit të mbledhjes. Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i nje ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në

mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur", Komisioneri kërkoj nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për zotërimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik ka sqaruar se: "...si edhe përcaktohet në nenin 17, pika 1 e ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore": "Mbledhjet e këshillit të bashkisë janë të hapura për publikun. Çdo shtetas lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit". Kërkuesit nuk i është mohuar asnjëherë e drejta për të ndjekur mbledhjet e Këshillit Bashkiak Kamëz dhe në lidhje me kërkesat e tij i jemi përgjigjur edhe në mënyrë elektronike nëpërmjet e-mail-it ku është informuar se: të gjitha Vendimet e Këshillit Bashkiak Kamëz i gjeni në faqen zyrtare të Bashkisë Kamëz." Ankuesi kërkon vijimin e ankimit dhe detyrimin e Autoritetit Publik të vendosë në dispozicion informacionin, me pretendimin se: "...nuk ka marrë përgjigje për asnjërën nga tre pikat e kërkuara edhe pse janë të detyruar të japin informacion si nga rregullorja dhe nga LDI". Me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, Zyra e Komisionerit ftoi palët në një seancë dëgjimore, në mungesë të ankuesit dhe prezencën e përfaqësuesëve të Autoritetit Publik. Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e Autoritetit Publik, cituan qëndrimin e mbajtur, por ndërkohë morën përsipër të vendosin në dispozicion dokumentacionin e zotëruar. Në vijim, Autoriteti Publik, ka kthyer përgjigje duke vendosur në dispozicion linkun e vendimeve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Kamëz <https://we.tl/t-ExmtFnlyN7>.

Nga shqyrtimi i çështjes, konstatohet se objekti i kërkesës për informacion lidhet me procedurën e mbajtur gjatë zhvillimeve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, e cila bazohet në ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Ligj ky, i cili, në Kreun VI të tij, parashikon edhe detyrimin për bërjen transparente të veprimtarisë së njësive të qeverisjes vendore. Konkretisht në nenin 15 "Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore" të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, parashikohet se:

"1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. 2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike...".

Përveç legjislacionit të posaçëm, i cili detyron Autoritetin Publik për të zhvilluar dhe administruar këtë procedurë, Komisioneri konstaton se, informacioni i kërkuar në pikat 2 dhe 3 të kërkesës për informacion, përfshihet në kategorinë e informacionit, që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë. Konkretisht, bazuar në pikën 3 "Organi përfaqësues i Bashkisë - Këshilli bashkiak", të fushës 1 "Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë", të Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore miratuar me Urdhrin nr. 211, datë 10.9.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në të cilin parashikohet: Organi përfaqësues i Bashkisë - Këshilli bashkiak (procesi i vendimmarrjes). Përfshin bërjen publike të:

- Njoftimet për mbledhjen e KB;
- Procesverbalet e mbledhjeve të KB...


Nga shqyrtimi i programit të transparencës së Autoritetit Publik, publikuar në linkun <https://kamza.gov.al/tabela-permbledhese-e-programit-te-transparences-3/>, konstatohet se ky detyrim nuk rezulton i përmbushur. Konkretisht, lidhja "Njoftimet për mbledhjen e KB", nuk aksesohet, ndërkohë, në lidhjen "procesverbalet e mbledhjeve të KB", Autoriteti Publik citon vetëm se: "Proces-verbalet ndodhen në sekretarinë e Këshillit Bashkiak të cilat mund ti vëmë në dispozicion tuaj në prezencë dhe se mbledhjet e Këshillit mbahen të hapura për çdo të interesuar që do të jetë pjesëmarrës".

Ndërkohë, dokumentacioni i kërkuar në pikën 1 të kërkesës për informacion, përfshihet në ato kategori informacioni që vendoset në dispozicion, pas kërkesës së subjektit të interesuar, në përputhje me parashikimet e nenit 11 e vijues të LDI. Detyrim ky i cili nuk është përmbushur nga Autoriteti Publik.

Në përfundim Zyra e Komisionerit vendosi, urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion. Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al.

Procesi i integritit evropian, përmirësimi i kapaciteteve profesionale

Në kuadër të procesit të integritit evropian, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka një rol aktiv duke qënë pjesë, ndër të tjera, edhe e Reformës në Administratën Publike.



Për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe administrative, Bashkimi Evropian do të mbështesë projektin “Qelizat e Reja” (Young Cells), i cili parashikon zhvillimin e trajnimeve dhe praktikave në institucione të vendeve anëtare të Unionit. Zyra e Komisionerit është një prej autoriteteve të përfshira në këtë iniciativë dhe për këtë qëllim, u zhvillua një takim me ekspertet e projektit znj. Anne Azam-Pradeilles dhe znj. Maylis De Verneuil.

Zbatimi i tij bazohet në përzgjedhjen mbi bazë merite dhe përgatitjen e një numri nëpunësish të administratës publike shqiptare, duke pasur në konsideratë edhe prioritetet në funksion të procesit të negociatave me BE.

Zyra e Komisionerit merr pjesë në takimin bilateral screening të kapitullit 10.


Në kuadër të procesit të integrimit në Bashkimin Evropian, Zyra e Komisionerit ka marrë pjesë në takimin bilateral screening të kapitullit 10, si pjesë e ekipit negociator për integrimin e Shqipërisë në BE. Zyra e Komisionerit mbajti një prezantim mbi të dhënat e hapura dhe Ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.



Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



[idp.albania](https://www.instagram.com/idp.albania)



[IDP Albania](https://twitter.com/IDPAlbania)



[Komisioneri KDIMDP](https://www.youtube.com/channel/UC...)